

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ta përgatisim Shqipërinë për integrim të plotë në BE", Peleshi: Rishikimi i statusit të deputetit është një nevojë e domosdoshme
ADRESA	https://tpz.al/ta-pergatisim-shqiperine-per-integrim-te-plote-ne-be-peleshi-rishikimi-i-statusit-te-deputetit-eshte-nje-nevoje-e-domosdoshme-i332377
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:47:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 15:40:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2492bf18df8d931b4fefe98ccaab5d33840897b0ef8a31ea7413fad73c5fa8d
TEKSTI	874a08b42665ab6eba9adeeb9eb5016e37bb4d2a6d1e361d7d7bebe271b9545f
PAMJA	eeae13cef25d4b66403d10505243137a78004d990e8660bab387443775e0194e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fbae10e05c94b3db31eb7557173b5cdf2d208cd632f1127389a70f3937cab959
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/fbae10e05c94b3db31eb7557173b5cdf2d208cd632f1127389a70f3937cab959

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 8 SEPTEMBER 2026, 17:40

“Ta përgatisim Shqipërinë për integrim të plotë në BE”, Peleshi: Rishikimi i statusit të deputetit është një nevojë e domosdoshme

tpz.al TPZ



Kuvendi i Shqipërisë ka çelur sot punimet e Sesionit të III-të të Legjislaturës XI, duke rikthyer aktivitetin parlamentar.

Në seancën e parë plenare të sesionit të ri, fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, i cili vuri theksin te përgjegjësia e Parlamentit për të vijuar punën në funksion të qytetarëve dhe të interesit të vendit.

Në fjalën e tij, Peleshi nënvizoi rëndësinë e një Kuvendi aktiv, të hapur ndaj qytetarëve dhe të fokusuar te sfidat dhe prioritetet e Shqipërisë në këtë fazë të zhvillimit të saj.

“Ky sesion duhet të jetë një tjetër hap përpara në forcimin e rolit të Kuvendit, në cilësinë e ligjbërjes dhe në përmbushjen e përgjegjësisë tona ndaj qytetarëve”, theksoi Kryetari i Kuvendit.

Peleshi u ndal edhe te procesi i integrimit europian, duke e cilësuar atë një nga prioritetet madhore të vendit dhe një përgjegjësi që kërkon angazhim të përbashkët institucional.

Ai vlerësoi gjithashtu nevojën për dialog parlamentar, bashkëpunim dhe respektim të rolit të institucioneve, duke theksuar se qytetarët presin nga përfaqësuesit e tyre punë konkrete dhe rezultate.

Sesioni i ri parlamentar nis me një axhendë të ngjeshur, ndërsa Kuvendi pritet të vijojë shqyrtimin e nismave ligjore, reformave dhe çështjeve me rëndësi për vendin.

“Punën tonë duhet ta masim me atë që arrijmë për qytetarët dhe për Shqipërinë”, ishte mesazhi i Kryetarit të Kuvendit në nisjen e sesionit të ri.

Fjala e plotë:

ide!

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

Nga Thoma Gëllçi

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!

Nga Mero Baze

Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, Të dashur qytetarë,

Sot çelim sesionin e tretë të Legjislaturës së 11-të të Kuvendit.

Lamë pas një sesion intensiv dhe produktiv. Miratuam 90 akte, ndër të cilat 21 ligje parësore, 37 ligje ndryshuese, 28 marrëveshje ndërkombëtare dhe 4 akte normative me fuqinë e ligjit.

Një pjesë e rëndësishme e kësaj veprimtarie i shërbeu drejtpërdrejt përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian. Zhvilluam 41 interpelanca dhe 10 seanca pyetje-përgjigje.

Forcuam mekanizmat e kontrollit parlamentar dhe konsoliduam një model të ri të raportimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura. U hartua dhe filloi zbatimi i Kalendarit Vjetor të Mbikëqyrjes Parlamentare. U miratua Plan Strategjik i Kuvendit për vitet 2026–2030, Plan i përkatës i Veprimit, si dhe struktura e re e shërbimeve parlamentare.

Vijuam modernizimin teknologjik të Kuvendit, digjitalizimin e shërbimeve dhe përfshirjen graduale të Intelligjencës Artificiale në proceset parlamentare.

Por, ndër arritjet e sesionit të kaluar, njëra prej tyre ka një rëndësi të veçantë: kontributi i Kuvendit në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Zhvilluam një diplomaci parlamentare intensive dhe vizituam e bashkëpunuam me më shumë se gjysmën e parlamenteve të vendeve anëtare. Dhe ky nuk ishte thjesht një aktivitet diplomatik; ishte një investim politik në anëtarësimin e Shqipërisë në familjen evropiane.

Integrimi evropian mbetet prioriteti numër një i punës së Kuvendit edhe gjatë këtij sesioni.

Jo thjesht si raunde negociatash, por si një proces transformimi i institucioneve demokratike, i ekonomisë dhe mirëqenies.

Kuvendi duhet të jetë një nga motorët e këtij procesi.

Gjatë këtij sesioni do të punojmë në tri drejtime themelore.

Së pari, përafrimi i legjislacionit.

Kuvendi do të shqyrtojë me përparësi projektligjet që lidhen me standardet e Bashkimit Evropian dhe me përmbushjen e detyrimeve të negociatave duke u fokusuar te rezultatet.

Ndaj, pas riorganizimit të tij, do të rrisim bashkëpunimin ndërmjet Shërbimit Legjislativ, strukturave përgjegjëse për përafrimin dhe Institutit Parlamentar.

Do të forcojmë kontrollin post-legjislativ, sepse detyra e Kuvendit nuk përfundon kur një ligj votohet, por vazhdon edhe gjatë zbatimit dhe vlerësimit të efekteve të tij.

Së dyti, intensifikimi i diplomacisë parlamentare.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian kërkon mbështetjen e institucioneve evropiane, të qeverive dhe të parlamenteve të vendeve anëtare. Kontaktet dinamike me parlamentet e 27 vendeve anëtare do të vazhdojnë.

Në 28 shtator, Kuvendi do të organizojë në Tiranë Konferencën Ndërparlamentare "Agjenda Strategjike e Zgjerimit të BE-së dhe anëtarësimi i Shqipërisë", e cila do të mbledhë përfaqësues të parlamenteve të vendeve anëtare, kandidatë dhe të institucioneve evropiane.

Ajo është një mundësi për të vendosur Shqipërinë në qendër të dialogut mbi të ardhmen e zgjerimit evropian.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces do të vazhdojnë të kenë Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian dhe Komisioni

për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Së treti, përgatitja për anëtarësimin e plotë.

Gjatë këtij sesioni do të fillojmë punën për t'u përgatitur edhe për mënyrën se si Shqipëria do të funksionojë si një vend anëtar me të drejta të plota.

Kjo kërkon plotësime ligjore dhe institucionale, një infrastrukturë të përshtatshme për pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes evropiane dhe përgatitjen e administratës për përgjegjësitë e reja.

Nuk do të presim ditën e anëtarësimit për të filluar përgatitjet për anëtarësimin. Do të fillojmë që sot.

III.

Ceshtje të rëndësishme të këtij sesioni mbeten edhe Reforma Zgjedhore dhe Reforma Administrative-Territoriale.

Këto janë dy procese të ndryshme, por të dyja lidhen me cilësinë e demokracisë, përfaqësimin dhe funksionimin e institucioneve.

Reformat tona duhet të afrojnë më shumë institucionet me qytetarin.

IV.

Në këtë frymë, do të përmirësojmë kuadrin ligjor për të ndërtuar urëkalime të reja ndërveprimi mes Qeverisë, deputetëve dhe zgjedhësve. Ne jemi këtu për të sjellë shqetësimet e njerëzve dhe për të kërkuar llogaridhënie, pa ndërhyrë e pa zëvendësuar kompetencat e institucioneve.

Autoriteti parlamentar nuk është privilegj. Është përgjegjësi. Nuk është çelës për dyer të mbyllura. Është detyrim për të hapur dyert e shtetit për qytetarin.

Ndaj, rishikimi i Statusit të Deputetit është një nevojë e domosdoshme, që ky mandat të shërbejë gjithmonë si instrument llogaridhënieje, mjet në shërbim të qytetarit, dhe jo simbullojë privilegjesh.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm i punës sonë duhet të jetë: të masim ligjbërjen jo vetëm me atë që prodhon në letra, por me atë që ndryshon në jetën e njerëzve.

Në fund të fundit, qytetari nuk jeton me statistika. Jeton me mundësi, me shërbime dhe me siguri. Rritja ka vlerë kur kthehet në mundësi. Ekonomia ka kuptim kur përkthehet në mirëqenie. Dhe zhvillimi ka kuptim vetëm kur ndihet në jetën e qytetarit.

VI.

Kuvendi do të vlerësojë nevojën për përmirësimin e legjislationit mjedisor dhe forcimin e mekanizmave për zbatimin e tij, pasi mjedisi është pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe e cilësisë së jetës.

Në një shoqëri demokratike, shqetësimet qytetare duhet të dëgjohen. Përgjigjja më e mirë ndaj tyre është transparenca, analiza dhe veprimi.

VII.

Të nderuar kolegë,

Sesioni i ri duhet të shënojë kalimin drejt një kontrolli parlamentar më të orientuar nga rezultatet. Sepse nuk mjafton të miratojmë rekomandime, por duhet të ndjekim zbatimin e tyre.

Do të vazhdojmë zbatimin e Kalendarit Vjetor të Mbikëqyrjes Parlamentare përmes seancave dëgjimore, vizitave monitoruese dhe dialogut me institucionet dhe grupet e interesit

Do të forcojmë vlerësimin e performancës së institucioneve të pavarura dhe përdorimin e Platformës Ndërinstitucionale Online për ndjekjen e rekomandimeve.

Do të trajtojmë me përgjegjësi çështjet që burojnë nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si një detyrim institucional dhe një element themelor i shtetit të së drejtës.

Për çështjet që kërkojnë ndërhyrje ligjore, përfshirë ato që lidhen me statusin dhe trajtimin e magistratëve, Kuvendi do të veprojë në përputhje me Kushtetutën, vendimet e Gjykatës dhe parimet e pavarësisë së drejtësisë.

Gjatë këtij sesi do të kemi gjithashtu përgjegjësi të rëndësishme për zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të pavarura, përfshirë procedurat për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

Këto procese duhet të zhvillohen me korrektësi, transparencë dhe profesionalizëm.

VIII.

Sesioni i ri do të jetë edhe një sesion i modernizimit të Kuvendit, si pjesë aktive e transformimit teknologjik të institucioneve demokratike. Do të zgjerojmë përdorimin e teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale për të rritur eficiencën, produktivitetin dhe transparencën e veprimtarisë parlamentare.

Por modernizimi nuk është vetëm çështje teknologjie. Ajo është mënyrë e re e të punuarit dhe e vendimarrjes.

Ligjet që miratojmë dhe kontrolli që ushtrojmë ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Prandaj, vendimarrja parlamentare duhet të mbështetet gjithnjë e më shumë në fakte, të dhëna dhe analiza të besueshme. Debatet politikë është i domosdoshëm, por nuk mund të jetë i vetmi burim i vendimarrjes.

Na duhen ligje që jo vetëm reagojnë ndaj problemeve, por i parashikojnë dhe u paraprijnë nevojave të shoqërisë.

Për këtë arsye, do të modernizojmë arkivën parlamentare dhe aksesin në dokumentacion; do të zhvillojmë mjete të Inteligjencës Artificiale për kërkimin legjislativ dhe analizën juridike; dhe do të zgjerojmë transparencën dhe aksesin e publikut në veprimtarinë e Kuvendit.

Ky modernizim do të shkojë paralelisht me sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, sepse një Kuvend më digjital duhet të jetë edhe një Kuvend më i sigurt.

IX.

Të nderuar kolegë, në mbyllje,

Ky Kuvend do të vlerësohet jo nga ajo që premton, por nga ajo që arrin.

Përtej dallimeve politike, projekti ynë më i madh kombëtar dhe përbashkues është i qartë: ta përgatisim Shqipërinë për anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian.

Ndaj, le ta bëjmë me seriozitet, me përgjegjësi dhe me rezultate.

Sepse Shqipëria e ka zgjedhur Evropën.

Tani duhet të vazhdojmë të bëjmë punën që na çon atje.

Mjedisi publik politik është dinamik dhe i ndikuar nga shumë faktore të njohur e të panjohur. Opinioni publik sot nuk formësohet vetëm nga politika konvencionale, nga debatet politike në kete salle.

Jetojme në një epokë të zhvillimit të vrullshëm të teknologjisë së komunikimit dhe Inteligjencës

Artificiale, ku opinionet individuale e gjejne hapësirën për të shprehur në mjedis të tjerë të rrjeteve sociale, jashtë organizimeve politike, duke e bërë politike më komplekse.

Në këtë mjedis të ri, partitë tona politike, pavarësisht mendimeve dhe programeve të ndryshme, duhet të qendrojnë bashkë në 2 parime:

Mbrojtjen e demokracisë konkurruese si formulë e vetme politike që garanton pluralizmin, dhe Ruajtjen e orientimit pro-europian e pro-amerikan, si zgjedhje strategjike e historike e vendit tonë.

Veshi ynë duhet të qendrojë i hapur për qytetaret, sidomos për ata që ndihen të lënë menjëherë dhe institucioni ynë duhet të jetë gjithnjë e më i hapur dhe reagues.

Ju faleminderit dhe ju uroj një sesion parlamentar të mbarë dhe me rezultate, për të gjithë!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur të faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.